



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

E - buletini no.16

Korrik 2018

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Aksioni për Zhvillim Rural (AZR) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret parasysh për të pasqyruar mendimet e Bashkimit Evropian



Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Banorëve Rural

'Kosta Veselinov' 3a,
1000 Skopje
R. Macedonia
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk
zg.akrra@yahoo.com

Organizatrat e implementimit





Sektori qytetar në mënyrë aktive do të kyçet në krijimin e politikave për zhvillim rural

Përfaqësues të më tepër se 40 organizata qytetare të Maqedonisë Perëndimor dhe Lindore që punojnë në tema të ndryshme në fushën e zhvillimit rural, në mënyrë aktive janë kyçur në procesin e ngritjen e kapaciteteve lidhur me analizën dhe krijimin e politikave për zhvillim rural, i zbatuar nga projekti «Parlamenti Rural Kombëtar i Zëri i Popullatës Rurale». Për këtë qëllim, projekti ka realizuar një cikël të tre trajnimeve në Ohër dhe Pehçevë, në periudhën prej shkurt deri qershor 2018.

E para prej gjithsej tre trajnimeve dyditore ishte zhvilluar në Ohër më 31 janar deri më 2 shkurt, për organizatat e Maqedonisë Perëndimore dhe në Pehçevë, prej 7 deri 9 shkurt për organizatat e Maqedonisë Lindore. Me anë të këtij trajnimi pjesëmarrësit kanë përfituar njohuri për politikën e zhvillimit rural në nivelin kombëtar dhe në nivelin e BE-së dhe kanë përfituar njohuri për lexim, interpretim dhe elaborim të politikave.

Trajnimi i dytë në temën “Përfaqësimi i bazuar në hulumtim” ishte zhvilluar në Ohër, në periudhën prej 9 deri 11 maj dhe në Pehçevë prej 16 deri 18 maj. Në kuadër të këtij trajnimi ishin përfshirë metodologji të ndryshme për zbatimin e hulumtimeve që janë në interes të organizatave rurale qytetare, metodologjia për përpunim dhe analizë të dhënave të fituara nga hulumtimet e zbatuara si dhe përdorimi përkatës i rezultateve të fituara në procesin e përfaqësimit të interesave të popullatës rurale para pushtetit lokal/kombëtar.





Trajnimi i tretë dhe i fundit i këtij cikli, i dedikuar “Realizimit të dialogut të qëndrueshëm mes organizatave rurale qytetare dhe autoritetet lokale/kombëtare në fushën e zhvillimit rural” ishte zhvilluar në Pehçevë, prej 6 deri 8 qershor dhe në Ohër prej 26 deri 28 qershor. Me anë të këtij trajnimi përfaqësuesit e organizatave qytetare kanë pasur mundësi të përfitojnë shkathtësi teknike të menaxhojnë me dialogun me palë tjera të interesuara/bartës të vendimeve, si të themelojnë partneritete, si të zbatojnë aktivitete në rrjet dhe si të kryejnë aktivitete për lobim dhe përfaqësim.

“Pa një sektor të bashkuar dhe të fuqishëm nuk mund të presim që do të kemi mjedise të zhvilluara sepse sektori qytetar është fuqi bartëse në mobilizimin e resurseve në mjediset rurale - ato njerëzore dhe natyrore”- theksoi Petar Gjorgievski, kryetar i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, që bashkon më tepër se 83 organizata qytetare nga gjithë Maqedonia. Ai theksoi që do të punohet në përfshirjen e banorëve lokale në përgatitjen e strategjive dhe programeve, si mjet i vetëm i qëndrueshëm për masa funksionale të zhvillimit rural.



Me anë të këtij lloji të procesit të ngritjes së kapaciteteve të sektorit qytetar, projekti “Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale” synon prezantimin e qasjes pjesëmarrëse në krijimin e politikave për zhvillim rural dhe krijim të partneriteteve mes sektorit qytetar dhe qeveritare për sjelljen e vendimeve të përbashkëta për përmirësim të jetës në mjediset rurale.





Projekte të përzgjedhura nga Programi për Grante të Vogla në kuadër të projektit “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale”

Me anë të skemës së nën-grantimit për ndihmë financiar në kuadër të projektit “Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale”, më 15 mars 2018 ishte hapur një thirrje për mbështetje të projekteve për organizata qytetare aktive në mjediset rurale. Qëllimi i këtij nën-grantimi ishte të përforcet bashkëpunimi mes organizatave qytetare dhe të përmirësohet dialogu i tyre me aktorët kryesor, si dhe autoritetet lokale, sektorin privat të përfshirë në zhvillimin rural të territorit.

Për gjithë organizatat e interesuara ishin organizuar takime informative, me qëllim të njoftimit më të hollësishëm me kriteret dhe kushtet për aplikim të kësaj thirrjeje. Organizatat qytetare kanë pasur mundësi të marrin pjesë në ndonjë prej takimeve informative të zhvilluar më:

- 21 mars në orën 11:00, në hotel “Kapri”, Manastir
- 23 mars, në orën 11:00, në restorantin “Gracija”, Kumanovë
- 26 mars, në orën 11:00, në restorantin “Princ”, Tetovë
- 28 mars, në orën 11, në hotel «Esperanto”, Strumicë



Thirrja nga Programi për Grante të Vogla i publikuar në kuadër të projektit “Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale” ishte mbyllur më 15 prill 2018. Në afatin kohor ishin parashtruar gjithsej 44 aplikime për projekte që kanë përfshirë 88 organizata qytetare që pu-

nojnë në fushën e zhvillimit rural.

Pas kontrollit të zbatuar cilësor dhe administrativ të aplikimeve për projekte, ekipi i vlerësimit ka përzgjedhur 10 projektet më të mira që kanë fituar mbështetje financiare nga Programi për Grante të Vogla. Aktivitetet e planifikuara





në kuadër të këtyre iniciativave për projekte do të zbatohen më së voni deri më janar 2019. Për realizimin e 10 projekteve të përzgjedhura, ishin ndarë gjithsej 3.684.000 de-

narë nga buxheti i projektit «Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale».

Më 14 maj, në Qendrën Informative të Be-së, ishin nënshkruar mar-

rëveshje me aplikantët e përzgjedhur dhe ata vetëm më kanë filluar me zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Aplikant	Partner	Titulli i aplikacionit
1 Koalicioni Rural Kumanovë	Shoqata për Zhvillim, Edukim dhe Etikë Ekologjike – POLIMAT 13	Komunat rurale dhe banores bashkërisht e ndërtojnë besimin dhe jetën në bashkësinë lokale
2 Shoqata për avancimin dhe zhvillimin e arsimit për të rritur «Rrjeti për Mësimin Gjatë Gjithë Jetës Tetovë»	Shoqata për Zhvillim Rural GLA Skardus Jegunovce	Mësimi gjatë gjithë jetës për zhvillim rural
3 Shoqata shumë etnike dhe joqeveritare femërore “Linda” Kumanovë	Fondacionit për Zhvillim të Ndërmarrjeve ë Vogla dhe të Mesme Kumanovë	Me anë të veprimit dhe përfaqësimit të përbashkët deri në biznes të suksesshëm për fermerët në Likovë dhe Staro Nagoriçane
4 Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor, Veçorive Kulturore-Historike dhe Shëndetin e Njeriut IZVOR Kratovë	Shoqata EKOKRATER KRATOVE – Kratovë	e-Portal Tursistik për rajonet rurale të Rajonit Verilindor
5 Shoqata e Prodhuesve të Llojeve Kopshtare dhe Luleve “HORTI EKO” Strumicë	Shoqata për Qëllime Arsimore-Edukative DM LANGUAGES	Përforcimi i kapaciteteve të organizatave qytetare për arritjen e nivelit më të lartë të qëndrueshmërisë dhe fuqisë së përfaqësimit
6 Qendra për Qëndrueshmëri dhe Edukim të Avancuar	Shoqata për Zhvillim të Qëndrueshëm PELISTER f. Rotino	Shërbim + - Përforcimi financiar i organizatave lokale rurale me anë të ngritjes së kapaciteteve të tyre për furnizimin e shërbimeve të paguara të anëtarësisë
7 Shoqata Qendra Kreative RURBANKULT – Strugë	Shoqata e Bletarëve MATICA 2012 Strugë	FERMA ORGANIKE – Kohezioni rural për potencial të rritur të turizmit rural dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe rural
8 Shoqata e Fermerëve Gra AGRO-VINKA Vinicë	Shoqata Radika-De Dibër	Përforcimi ekonomik i grave rurale të përkatësive të ndryshme etnike të rajonit Lindor dhe Perëndimor
9 Shoqata për Mbrojtje, Promovim dhe Edukim për Ushqim Slow Food Bitola - Manastir	1. Shoqata për Mbrojtje dhe Promovim të Piperit Buk Presidum Bukovo – Manastir 2. Shoqata për mbrojtjen, promovimin dhe edukimit për ushqim Slow Food Osogovë	Krijimi i listës fillestare të produkteve tradicionale për mjedise të qëndrueshme rurale - SILOS
10 Shoqata e Qytetarëve EKOVIDA	Shoqata e prodhuesve të ushqimit organik Biovita – Kavadar	Të drejtë ndaj natyrës



Anketë për identifikimin e temave relevante për nevojat e komuniteteve lokale

Gjatë periudhës prej majit deri në qershor, projekti «Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale» ka zhvilluar një anketë në 8 rajonet e planifikimit në Maqedoni, për të përcaktuar temat që janë relevante për nevojat e komuniteteve rurale, që më tutje do të trajtohen me anë të përgatitjeve të brifingjeve politike. Për identifikimin e problemeve dhe nevojave në nivelin lokal, ekipi i projektit ka përgatitur një pyetësor anketues që ishte shpërndarë 8 anketuesve në teren dhe ishte plotësuar nga më tepër se 840 përfaqësuesve të sektorit civil dhe vetëqeverisjes lokale. Të dhënat e mbledhura nga py-

etësorët ishin të përpunuar në kuptimin cilësor dhe sasior dhe si rezultat 8 tema të ndryshme ishin përcaktuar me rëndësi për informacionet në secilin prej rajoneve të planifikimit.

Ky aktivitet do të ndihmojë organizatat që ishin përfshirë më herët në trajnimet për zhvillimin e kapaciteteve të tyre në përfaqësim, lobim dhe rrjetëzim për të përgatitur brifingje politike për nevojat e komuniteteve rurale në rajonet e planifikimit të Maqedonisë. Me anë të aktiviteteve të planifikuara, projekti synon përmirësimin e ndikimit të OJQ-ve dhe përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes dhe zhvillimin e politikave publike.

Zhvillohet për herë të parë Parlamenti Rural Ballkanik në Vrnjačka Banja

Në bazë të përvojës së madhe të përfituar nga parlamentet kombëtare rurale në gjithë Evropën, rrjetet kombëtare për zhvillim rural të Ballkanit Perëndimor (Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Bosnjës dhe Hercegovinës, Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural i Kosovës, Rrjeti për Zhvillim Rural i Malit të Zi dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Kroacisë) në bashkëpunim me Fondacionin për Zhvillim nga Turqia, PREPARE dhe Forumi Rural i Latvisë, për herë të parë në historinë e Evropës rurale kanë organizuar Parlamentin Rural Ballkanik rajonal.





Parlamenti i Parë Ballkanik Rural, që ishte zhvilluar prej 26 deri më 28 qershor 2018 ishte vizituar nga rreth 60 përfaqësues të sektorit qytetar dhe publik të Ballkanit Perëndimor dhe Turqia, përfaqësues të Komisionit Evropian, rrjetet kombëtare rurale të gjithë Evropës, rrjetet ndërkombëtare dhe organizatat dhe shumë aktorë tjerë rural.

Qëllimet kryesore të Parlamentit të Parë Rural Ballkanik ishin:

- Të mbështetet bashkëpunimi rajonal dhe ndër-sektorial për aktorët kryesor në zhvillimin rural të Ballkanit;
- Të ngrihet zëri i popullatës rurale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi;
- Të promovohet vetë-ndihmë dhe aktivizëm tek popullata rurale, në partneritet me sektorin qytetar dhe publik;
- Të përcaktohen rekomandimet kryesore për zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve rurale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi;
- Të përcaktohen rekomandimet kryesore tek institucionet e BE-së dhe qeveritë kombëtare, lidhur me integrimin në BE të rajonit në bazë të nevojave rajonale dhe specifikat e mjediseve rurale.

Në kuadër të ngjarjes, ishin organizuar grupe pune që kanë diskutuar në 5 tema të ndryshme:

- Të rinjtë dhe gratë në zhvillimin rural të Ballkanit;
- Zinxhir i shkurtuar i furnizimit dhe roli i rrjeteve në Ballkan;
- Sipërmarrja sociale si mundësi për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në komunitetet rurale të Ballkanit;
- Si të përdoret LEADER/CLLD për zhvillim më të shpejtë të komuniteteve rurale në Ballkan;
- Trashëgimia kulturore e Ballkanit si mundësi për zhvillim rural.

Konkluzionet dhe rekomandimet nga puna në grupe ishin përmbledhur dhe integruar në Deklaratën e Parlamentit të Parë Rural Ballkanik, që si produkt të fundit i ngjarjes do të adresohet tek autoritetet kombëtare dhe institucionet e BE-së.





Aktivitete të ZUR "ARTI KRAFT" – Shkup

Këtë vit, shoqata e artizanëve artistë "ARTI KRAFT" ka shënuar pesë vite nga puna e suksesshme, me hapjen e një Ode Etno në Shkup. Në Odën Etno janë ekspozuar produkte tradicionale dhe etno, si dhe gjëra të përpunuar nga komunitet të ndryshme etnike nga Maqedonia dhe nga anëtarët e "ARTI KRAFT". Vëmendje të veçantë kanë tërhequr veshjet popullore të veçantë për rajonin e Blitisë së Shkupit dhe Malit të Zi të Shkupit, që janë në pronësi të Mr. Dostana Karagjozoska Stankovka nga Shkupi, koleksionere e veshjeve popullore.





“ARTI KRAFT” edhe këtë vit ka organizuar Pazarin Pranveror e arteve vendore, në kuadër të së cilit u zhvillua edhe zgjedhja e suvenirit më origjinal të qytetit të Shkupit, me rastin e Mësuesve të Mëdhenj Sllav, Shën Kirili dhe Metodi. Tre autorët më të suksesshëm (Rade Stankovski - vendi i parë; Vesna Veličkoviç - vendi i dytë; Boris Popev - vendi i tretë), u shpërblyen me të holla, kurse veprat e shpërblyera ju dhuruan qytetit të Shkupit.

Ngjarja treditore, ku u nderuan tradita dhe artizanati, në kishën Shën Spas në Shkup, ofroi një mundësi për anëtarët e “ARTI KRAFT” dhe artistëve tjerë që të promovojnë punimet e afta të dorës para vizituesve të shumtë. Në program morën pjesë edhe nxënës të shkollës të SH.F. «Sv. Kiril i Metodij» nga Shkupi, KUD “Vera Jociç” nga Makedonska Kamenica, DMA «SRMA» nga Kumanova, Studioja e modës e «Etno Beba» nga Shkupi me sfilatë mode, si dhe legjenda e këngëve popullore maqedonase Violeta Tomovska.

Shoqata “ARTI KRAFT” ka marr pjesëmarrje aktive në shumë seminare, punëtori dhe tribuna, kurse me punimet e dorës u prezantua në “Ditët e qershisë” në Mostar/BH në qershor 2018 dhe në Festivalin e muzikës dhe artit, në Sofje/Bulgari në qershor 2018.





Themelohet Grupi Lokal i Aksionit “BOJMIJA”

Më 7 shkurt 2018, në Shtëpinë e Kulturës në Bogdanci u zhvilluar Kuvendi Themelues i Shoqatës Grupi Lokal i Aksionit (GLA) Bojmija. Themelues të Shoqatës janë katër komunitet e Jugut të R. së Maqedonisë, Gjevgjeli, Vallandovë, Dojran dhe Bogdanci, ndërsa si bashkëthemelues janë regjistruar disa ndër marrje, organizata joqeveritare dhe persona fizik. Aderimi në Shoqatën GLA Bojmija është në bazë vullnetare dhe mund të bëhet zgjerimi me anëtarë juridik ose persona fizik nga komunitet e theksuara.

Qëllimi kryesor i Shoqatës është nxitja dhe avancimi i zhvillimit rural me aktivitete të caktuara për zgjedhjen prioritare të problemeve të sektorëve të marginalizuar dhe të pazhvilluar të rajoneve rurale. Iniciatorë të Shoqatës Grupi Lokal i Aksionit Bojmija kanë përgatitur Strategji për Zhvillim Lokal të Mjedisit Rural për rajonin e caktuar në përputhje me LEADER parimet për përdorim të mundshëm të fondeve të aderimit të BE-së në të ardhmen si dhe burime tjera të financimit në rajon.

Për kryetar të Shoqatës është zgjedhur Risto Atanasovski nga Gjevgjelia, për kryetar të Bordit Drejtues – Mitko Vllahov nga Bogdanci, për kryetar të Bordit Mbikëqyrës – Darko Kaçakov nga Dojran, për kryetar të Komisionit për Vlerësimin e Projekteve – Kostadin Neveslinovski nga Vallandova.

Më 30.05.2018 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit ka shpërndarë vendimet për regjistrim të Grupeve Lokale të Aksionit (GLA) për regjistrim në Regjistrin Unik të Republikës së Maqedonisë. Mes tyre vendim për regjistrim fitoi edhe GLA “Bojmija”, i themeluar nga persona juridik dhe fizik të komunave Gjevgjeli, Bogdanci, Vallandovë dhe Dojran. Kryetari i GLA «Bojmija», Risto Atanasovski, që morri vendimin, theksoi që me zbatimin e strategjisë së hartuar do të mundësohet që fermerët dhe popullata rurale drejtpërdrejtë të orientojnë kërkesat e tyre në lidhje me zhvillimin e mjedisit rural dhe jo vetëm në kuptim të bujqësisë, por edhe në kuptim të përmirësimit të infrastrukturës rurale, zhvillimit të turizmit rural dhe përmirësimit të mjedisit jetësor.



Për këtë qëllim nga Programi për Zhvillim Rural për vitin 2018 janë parashikuar 10 milion denarë për animacion dhe edukim të GLA-ve. Mbështetja financiare dhe administrative do të vazhdojë deri në akreditimin e masës LEADER me anë të IPARD Programit.





Projekti “Përsheptues i njohurisë së MSP” (MEKA)

Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike – Gjevgjeli (FLORIT) në vitin 2017 ka hartuar një projekt për zmadhimin e konkurrencës së MSP sektorit në të cilën theks të veçantë është vendosur në mikro kompanitë. Nevoja ka dalë nga qasja e vështirë në financa dhe absorbimi i ulët i fondeve të BE-së që theksohen si një prej kufizimeve më të mëdha të MSP sektorit në Maqedoni. Mbështetja është e nevojshme jo vetëm në pjesën si të fillohet biznes personal, por edhe shumë më rëndësi, mënyrën e drejtimit, zhvillimit dhe si të bëni biznesin tuaj më fitimprurës.

Në projektin janë parashikuar masa dhe aktivitete që do të mundësojnë mikro kompanive (kompani me numër të të punësuarve prej 1-9 persona) të jenë konkurrent në tregun me anë të absorbimit më të mirë të fondeve të BE-së.

Me anë të projektit, mes tjerash, planifikohet përforcimi i shkathësive të menaxherëve të kompanive të reja mikro me njohuri dhe kompetenca, që do të mundësojë të zhvillojnë kompanitë e tyre në biznese të suksesshme, të qëndrueshme dhe fitimprurëse. Pikërisht për këtë temë, projekti ka organizuar një konferencë më 27 qershor, në Gjevgjeli. Në fillim të ftuarve ju drejtuar kryetari i komunës së Gjevgjelisë, Mr. Sasho Pockov, që theksoi se është shumë krenar që merr pjesë në promovimin e një projekti me këtë përmasë, të synuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me të cilin nxitet mbështetja dhe zhvillimi i këtyre subjekteve ekonomike që marrin pjesë dhe kontribuojnë për zhvillim lokal ekonomik.

“Si shtet dhe si vetëqeverisje lokale japim mbështetje të plotë këtyre projekteve që kanë për qëllim rritjen e motivimit të ndërmarrjeve të vogla dhe mesme për të përdorur fondet e gatshme të Bashkimit Evropian që i kanë në dispozicion jo vetëm të vendeve anëtare të BE-së por edhe vendeve kandidatë për anëtarësi, siç është rasti me Republikën e Maqedonisë”, theksoi Pockov.

Qëllimi, grupet e synimit, aktivitetet dhe rezultatet e pritura ishin sqaruar në hollësi nga drejtori i Fondacionit për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike - Gjevgjeli, z. Risto Atanasovski. Për rendësin e inovacioneve si mjet për rritjen e konkurrencës ka folur Dr. Alek Karaev.

Projekti “Përsheptues i njohurisë së MSP” (MEKA) është financuar nga Bashkimi Evropian me anë të Programit Kombëtar për Ndihmë Transitive dhe Mbindërtim Institucional 2013, Instrumenti për Ndihmë Para Aderimi (IPA), EuropeAid/138-495/ID/ACT/MK, dhe zbaton Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike – Gjevgjeli në partneritet me Organizatën e Grave – Shtip.





Ngritja e kapaciteteve për zhvillim të qëndrueshëm për Grupet Lokale të Aksionit – GLA për proceset e integritimit në BE – “BUILDLAG”

Përshkrim i projektit:

Projekti ka për qëllim përf forcimin e partneritetit privat -publik mes organizatave joqeveritare rurale, asociacioneve afariste dhe autoriteteve lokale me anë të transferimit të njohurive, praktikave më të mira dhe përvojës së transferuar nga BE për themelimin dhe funksionimin e Grupeve Lokale të Aksionit. Grupet synuese të projektit janë organizata joqeveritare rurale maqedonase, asociacionet afariste si dhe pushtetet lokale. Kyçja e gjithë aktorëve në projektin do të mundësojë zhvillim dhe avancim të tyre, do të nxit partneritete për aktivitete të përbashkëta dhe do të nënkuptojë kontribut për proceset globale në këtë fushë.

Qëllime specifike:

- Të rrite njohuria dhe të përforcohen kapacitetet e shoqërisë qytetare dhe autoritetet lokale për funksionim të qëndrueshëm të GLA-ve me anë të transferimit të përvojave dhe praktikave më të mira të BE-së.
- Të vendoset partneritet funksional mes shoqërisë qytetare dhe autoriteteve lokale në Grupin Lokal të Aksionit të ri dhe mbështetje përkatëse.
- Të sigurohen rekomandime për politika të promovimit të GLA-ve dhe përfitimet prej tyre.
- Të ngritet vetëdija publike për përparësitë e GLA-ve dhe politikave të integruara të BE-së.

Në kuadër të projektit janë parashikuar aktivitete në vijim:

- Trajnim për OJQ-të për rëndësinë e tyre për GLA-të;
- Vizitë studimore të GLA-ve në BE;
- Themelimi i GLA-së në rajonin e planifikimit të Pollogut;
- Zhvillimi i strategjisë së integruar dhe plan veprimit për GLA të sapoformuar;
- Sigurimi i rekomandimeve për politika;
- Zhvillimi i ueb faqes për projektin, që do të vazhdojë të jetë në funksion si ueb faqe të GLA të sapoformuar në RPP.



Zbatues i projektit është:

- 3G Qendra për Promovim të Praktikave të Qëndrueshme Bujqësore dhe Zhvillimi Rural - CeProSARD

Partnerë të projektit janë:

- Grupi Lokal i Aksionit Una nga Kroacia
- Asociacioni i Fermerëve të Rinj Asaja Granada nga Spanja

Kohëzgjatja e projektit:

19 dhjetor 2017 – 19 qershor 2019

Donator: Bashkimi Evropian

Institucione të përfshira:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit
- Qendra për Zhvillim të Rajonit të Planifikimit të Pollogut





Me anë të gra ferme të informuar, të edukuar dhe trajnuar deri tek agro-afaristë të suksesshëm

Shoqata "Horti Eko" nga f. Dobrejci, rrethina e Strumicës, ka filluar me zbatimin e projektit **"Me anë të gra fermerë të informuar, të edukuar dhe trajnuar deri tek agro-afaristë të suksesshëm"** që është mbështetur financiarisht nga komuna e Strumicës, me anë të programit për edukimin joformal në bujqësi dhe mbështetje të grave fermere për transmetimin e njohurive për përdorim më të mirë të programeve nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe përforsimit të kapaciteteve të grave të përfshirë në sektorin bujqësor.

Programit IPARD është një mundësi e madhe për ndihmë financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, por është e gatshme vetëm për ata që janë mirë të informuar, të edukuar dhe janë në gjendje të investojnë mjete personale. "Horti Eko" do të fillojë një fushatë për përmirësim të informimit në lidhje me IPARD, për gratë nga mjediset rurale, në rrethinën e Strumicës, që në mënyrë aktive merren me veprimtarinë bujqësore, me qëllim që të fitojnë qasje në mjetet e IPARD-it që të mund në mënyrë efektive të përdorin. Në kohë e njëjtë, grave fermere ju mungon mundësi për mbindërtimin e njohurive dhe arsimit të tyre, që jo vetëm që do të kontribuojë për përfitim më të lartë nga puna, por edhe do të inkurajojë që të pranojë politikat që vijnë me aderimin drejt BE-së.



Duke u nisur nga këto nevoja, "Horti Eko" në sajë të këtij projekti do të zbatojë një model të përgjithshëm të edukimit, me anë të cilës gratë fermerë do të rrisin kapacitetet për zbatimin e standardeve përkatëse në bujqësi dhe do të mësojnë si më mirë të planifikojnë punën e tyre, të zgjerojnë biznesin dhe të rrisin përfitimin.

Grupi synues i projektit janë gratë nga mjediset rurale të komunës së Strumicës që në mënyrë aktive janë të kyçur në sektorin bujqësor. Me këtë projekt, "Horti Eko" do të mundohet që të ndikojë në

mënyrë pozitive mbi imazhin e bujqësisë në rajonin e Strumicës, duke e promovuar gruan fermer si një agro afarist të suksesshëm dhe do të prish thënien që bujqësia është për ata që nuk kanë mundur të sigurojnë punësim tjetër.

Aktivitetet e projektit vetëm më janë të filluar dhe me sukses janë realizuar disa trajnime në pjesën e **praktika të mira bujqësore, ndikimi i ndryshimeve klimatike në bujqësi dhe planifikimi afarist**. Viojnë edhe shumë trajnime tjera në të cilat do të përfshihen gratë nga mjediset rurale të rajonit.





Panairi Ndërkombëtar Bujqësor Agrotika 2018 në Selanik, Greqi

Një grup prej 100 fermerëve në organizim të shoqatës "Horti Eko" nga Strumica, më 03.02.2018 kanë marrë pjesë në edicionin e 27 të Panairit Ndërkombëtar Bujqësor Agrotika në Selanik, Greqi. Në panair fermerët kanë pasur mundësi të njoftohen me teknologji të reja dhe ishin prezantuar edhe arritjet më të reja botërore në pjesën e mekanizimit bujqësor, pajisje dhe materiale prodhimi.

Qëllim i vizitës së panairit ishte të shkëmbehen përvoja dhe ide, të shikohet zbatimi praktik i teknikave të reja dhe teknologjive në bujqësi si dhe nxitje të zbatimit të tyre tek ne, kopjim të mënyrave inovative të prodhimit dhe realizimit të bashkëpunimit afarist.



Festival i Verës së Mellnikut "Zllaten Grozd"

Shoqata "Horti Eko" në ftesë të bashkëpunëtorëve të tyre - shoqatat bujqësore nga Bullgaria, me rastin e ditës së vreshtarëve Shën Trifuni, ka vizituar Festivalin e Verës së Mellnikut "Zllaten Grozd" që në mënyrë tradicionale, për herën e shtatë është zhvilluar në qytetin më të vogël të Republikës së Bullgarisë dhe Evropë – Mellnik. Kjo është një prej manifestimeve më të vizituara në rajon në të cilën ishin prezantuar verërat më të bukura, ushqim tradicional, program të pasur folklorik dhe zakone tradicionale bullgare.

Fermerët kanë pasur mundësi të vizitojnë Verërinë Villa Mellnik - një verëri bashkëkohore që dallohet me pajisjen më bashkëkohore për verë dhe staf të dedikuar me kualifikime të larta dhe gjatë kësaj të njoftohen me gjithë procesin e prodhimit të verës dhe të shijojnë verëra të njohura botërore me karakter të veçantë të Mellnikut.



Projekti “Rritja e Punësisë në Treg – IME” në Maqedoni

Projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim “Rritja e Punësisë në Treg - IME” në Maqedoni, në bashkëpunim me Institutin për Zhvillimin e Komunitetit - CDI Tetovë ka për qëllim zhvillimin e tregut që shpie drejt qasjes së përmirësuar në punësim të mirë dhe mundësi për të ardhura për të rinjtë dhe gratë në veçanti.

CDI-ja, si konsulent lokal, ka organizuar dhe mbështetur programin për të siguruar një seancë informimi - një ngjarje ditore që ishte zhvilluar më 26 prill në Tetovë dhe ka organizuar procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes së këshilltarëve aktual organik, distributorëve, eksportuesve, përpunuesve dhe pjesëmarrësve të kualifikuar aktual për të marrë pjesë në trajnimin për këshilltarë të prodhimit organik të planifikuar (program për ngritjen e kapaciteteve)

IME-ja është përqendruar në përforcimin e mungesave në zinxhirin e furnizimit, sigurimin e furnizimit të produkteve organike për blerësit e interesuar dhe zhvillimi i kanaleve alternative të distribucionit për prodhimtari më të lartë dhe shitje të produkteve organike.

Për këtë qëllim, CDI-ja si konsulent lokal:

- Ka organizuar proceset dhe ka mbështetur programin për zhvillimi e seancave informative për bujqësi organike në Tetovë duke mbuluar fermerë nga rajoni i Pollogut me fokus në fermerët gra, si nga përkatësia maqedone ashtu edhe ato shqiptare.
- Ka ftuar pjesëmarrës;
- Ka mbështetur programin për identifikimin e vendeve më të mira për ngjarjen.

Përfituesit e synuar janë fermerë nga rajoni i Pollogut me fokus në fermerët gra nga grupet etnike maqedone dhe shqiptare, aktorë të ndryshëm.





Ngjarje katër ditore – programi për ngritjen e kapaciteteve (TRA-JNIM për këshilltarët e prodhimit të planifikuar organik)

1 – 2 qershor 2018

8 – 9 qershor 2018



IME është përqendruar në aktivitete të synuar mbi rritjen e vetëdijes për prodhimtarinë e planifikuar organike për tregjet aktuale (tregjet lokale dhe të eksportit) dhe rrjetin e distribucionit si dhe për të ndihmuar fermerët të kenë qasje më të lehtë në informacione dhe njohuri për kultivimin e ushqimit organik.

Për këtë qëllim, CDI-ja, si konsulent lokal, ka organizuar një proces të identifikimit dhe përzgjedhjes së këshilltarëve aktual organik, distributorëve, eksportuesve, përpunuesve dhe pjesëmarrësve të kualifikuar aktual për të marrë pjesë në trajnimin për këshilltarë të prodhimit organik të planifikuar (program për ngritjen e kapaciteteve). Kjo ngjarje katër ditore ishte përbërë nga dy pjesë: pjesa teorike dhe ajo praktike.

Pjesa teorike ishte organizuar në Shkup gjatë periudhës prej 1 qershor deri më 2 qershor, ndërsa pjesa praktike ishte zbatuar në:

- Një fermë në Oreshani më 2 qershor – për kultura kopshtare;
- Një fermë në Strumicë më 8 qershor – POKROV;
- Një fermë në Kumanovë më 2 qershor dhe një fermë në Rankovce, Kriva Pallankë më 9 qershor – për kultura pemore.

Projekti ka përmirësuar njohurinë mbi bujqësinë organike për 21 pjesëmarrës, që do të këshillojnë fermerët për prodhimtarinë organike dhe proceset e certifikimit.



Përforcimi i kapaciteteve të shoqatave për pjesëmarrje participative në procesin e miratimit të dokumenteve publike dhe politikave në bujqësi dhe zhvillim rural

Në periudhën janar – mars 2018, shoqata “Koalicioni Rural”, në kuadër të projektit, “Përforcimi i Kapaciteteve të Shoqatave për Pjesëmarrje Participative në Procesin e Miratimit të Dokumenteve Publike dhe Politikave në Bujqësi dhe Zhvillim Rural” i mbështetur financiarisht nga programi Civica Mibilitas, ka realizuar 8 trajnime (nga një në secilin rajon të planifikimit) në temën e lobimit dhe përfaqësimit për përfaqësues të shoqatave lokale që veprojnë në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Gjithsej 160 fermerë dhe përfaqësues të shoqatave kanë pasur mundësinë të kalojnë trajnimin, dhe ky trajnim ka pasur për qëllim të nxit fermerët që më shpesh të parashtrojnë iniciativa qytetare si tek autoritetet lokale, ashtu edhe ato kombëtare. Përveç kësaj, në kuadër të projektit ishte hartuar edhe një manual “Përfaqësimi në Bujqësi!” që është i gatshëm edhe në formë elektronike dhe të shtypur në 3 gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht.

Manualin mund të merrni nga lidhja vijuese:

<http://rural.mk/публикации/>

Përveç kësaj, në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar edhe 8 tryeza të rumbullakët në të cilat ishin përfshirë edhe përfaqësues të institucioneve publike, fermerë dhe përfaqësues të komunave, me qëllim të shqyrtimit të Programit Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2018-2022, si dhe Programin për Zhvillim Rural 2018 dhe dhënieve të udhëzimeve për zbatimin më të mirë dhe më efektiv duke marrë parasysh që për momentin nga kjo shfrytëzohet vetëm 35%. Propozimet dhe ndryshimet në lloj të iniciativës qytetare të mbështetur nga ana e fermerëve do të dorëzohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit dhe në fund të muajit korrik 2018.





Zhvillimi strategjik i turizmit rural – bazë për lidhjen dhe plotësimin kom- plementar të politikës industriale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të RM-së

Në kuadër të projektit “Zhvillimi strategjik i turizmit rural – bazë për lidhjen dhe plotësimin komplementar të politikës industriale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të RM-së” që financiarisht është mbështetur nga fondacionit YES Network, si shërbim sipërmarrës për të rinj, shoqata “Koalicioni Rural” ka realizuar një hulumtim në teren për nevojat e pronarëve të kapaciteteve turistike në mjediset rurale. Ishin përfshirë mbi 120 pronarë të kapaciteteve rurale, janë zhvilluar 4 tryeza të rrumbullakët, gjatë së cilës njëra ishte edhe pjesë e Javës së Organizatave Qytetare të mbështetur në kuadër të fushatës së USAID për përfundimin e shoqërisë qytetare. Ishte hartuar edhe një analizë krahasuese e dokumenteve strategjike për zhvillim të turizmit rural për Maqedoninë, Bullgarinë dhe Kroacinë, që mund të gjendet në ueb faqen e organizatës www.rural.mk, dhe në faqen e njëjtë mund të gjendet edhe harta e kapaciteteve turistike që ishin të përfshirë në projektin.



Përfshirja e perspektivës gjinore në politikat kryesore të bujqësisë dhe zh- villimit rural

“Koalicioni Rural” në bashkëpunim partneriteti me Këshillin Kombëtar për Barazi Gjinore dhe me Shoqatën për Zhvillim Lokal dhe Rural, në kuadër të projektit

“Përfshirja e perspektivës gjinore në politikat kryesore të bujqësisë dhe zhvillimit rural”, që është financuar nga Bashkimi Evropian, ka zhvilluar një hulumtim në teren me 600 të anketuar (500 gra dhe 100 burra) që ka përfshirë gjithë aspektet e veprimit të gruas në mjediset rurale duke filluar nga pozita ekonomike dhe sociale, pastaj, pozita në shtëpinë, deri tek qasja dhe gatishmëria e shërbimeve sociale, shëndetësore, kulturore dhe tjera që përcaktojnë cilësinë e jetës së secilit individ.

Hulumtimi duhet të përcaktojë gjendjen e vërtetë dhe pozitën e gruas nga mjedisi rural i shoqërisë sonë, por edhe të jep rekomandime për avancimin e kësaj çështjeje. Hulumtimi ishte zbatuar në 5 pilot komuna: Kumanovë, Prilep, Strumicë, Gostivar dhe Strugë, në të cilin ishin përfshirë mbi 60 fshatra të hulumtuara, dhe ishin zhvilluar edhe 5 takime me përfaqësuesit e një-sive rajonale të MBPEU, ANZHB, Agjencisë së Punësimit, FPIM, Qendrën për Mbrotjtje Sociale, si dhe përfaqësues





të 5 komunave të përfshirë në aktivitetet e projektit. Në hulumtim ishin përfshirë 5 moderator lokal, si dhe 30 hulumtues që kanë kaluar trajnim për zbatimin e hulumtimit, dhe kanë pasur takim për shpërndarjen e njohurive. Në periudhën vijuese do të prezantohen rezultatet e hulumtimit në një konferencë, dhe do të realizohen trajnime dhe ngjarje informative që do të nxisin gratë të mjediseve rurale të aplikojnë më shumë në thirrjet publike dhe fonde për zhvillim rural përfshirë edhe IPARD.

Komuniteti lokal dhe komuna bashkërisht krijojnë strategjinë për zhvillim ekonomik lokal

“Koalicioni Rural” ka filluar procesin e krijimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në bashkëpunim të drejtpërdrejt me komunën e Staro Nagoriçanit, si pjesë e projektit **“Komuniteti lokal dhe komuna bashkërisht krijojnë strategjinë për zhvillim ekonomik lokal”**, të financuar nga ALDA. Janë zhvilluar takime me kryetaren e komunës z-një Zhaklina Jovanovska, përfaqësuesit e institucioneve lokale, si dhe banorët e komunës, me qëllim të formohet platformë lokale të aktorëve në komunën që do të krijojnë Strategjinë për ZEL me mbështetje eksperte.





Projekt “Të rinjtë nga mjediset rurale për integrim të Maqedonisë në BE”

Partnerë në projektin:



Fondacioni për Lindjen e Vlerave
Natyrore dhe Njerëz (CNVP)



RURAL DEVELOPMENT NETWORK
OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Rrjeti për Zhvillim Rural i
Maqedonisë



Rrjeti për Zhvillim Rural i Kroacisë



NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT
OF THE REPUBLIC OF SERBIA

Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë

Projekti është dizajnuar për të nxitur të rinjtë nga mjediset rurale dhe organizatat qytetare nga Rajoni i Planifikimit Lindor dhe Juglindor të kontribuojnë për proceset demokratike të sundimit, përfshirë edhe gjithë palët e interesuar si dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe përshtatje ndaj sfidave për integrim në BE.

Raporti për të Rinjtë i Be-së në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e aderimit në BE dhe proceset zhvillimore në vend. Gjithashtu, BE-ja inkurajon vendet të krijojnë mundësi të barabarta për arsimin e të rinjve dhe në tregun e punës, të promovojnë aktivizmin qytetar, përfshirjen sociale dhe solidaritetin mes të rinjve.

Qëllime të projektit:

1. Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave rinore dhe të rinjve nga mjediset rurale për krijimin dhe zbatimin e politikave publike me anë të dialogut me bartësit e vendimeve;
2. Përforcimi i kapaciteteve të të rinjve nga mjediset rurale për konkurrencë më të mirë në tregun e punës.

Rezultate të pritura:

1. Njohuri të zmadhuar të të rinjve nga mjediset rurale për çështjet lidhur me integrimin në BE;
2. Ngritje të vetëdijes së të rinjve nga mjediset rurale për rritjen e mundësive për zhvillimin e karrierës;
3. Përforcim të kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave rinore për aktivizëm rinor;
4. Krijimi i “Platformës Rajonale Rinore”;
5. Krijimi i mundësive për dialog efikas për politikat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrim në BE me ndërmjetësim të Platformës Rajonale Rinore;



Ngritja e kapaciteteve të të rinjve me qëllim që të bëhen faktor në krijimin e politikave lokale për zhvillim është qëllimi i projektit "Të rinjtë nga mjediset rurale për integrim të Maqedonisë në BE".

Projekti ishte promovuar më 27.02.2018 në Shkup dhe është financuar me mjetet e BE-së, dhe e zbatojnë katër organizata. Udhëheqësi i projektit është Dega në Maqedoni e Organizatës për Lidhje të Vlerave Natyrore dhe Njerëz (CNVP) me seli në Hagë, Holandë, ndërsa partnerë në zbatimin e projektit janë Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Kroacisë dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë.

Në ngjarjen promovuese ishte theksuar që projekti do të fokusohet në të rinjtë nga Rajoni i Planifikimit Lindor dhe Juglindor në Maqedoni ku organizatat zbatuese të projektit do të mundohen të animojnë të rinjtë dhe organizatat rinor që punojnë me të rinjtë që përforcojnë kapacitetet e tyre për aktivizëm rinor, zhvillim të karrierës dhe të aftësojnë për të ndikuar mbi sjelljen e politikave në nivelin lokal.

Migracioni i përditshëm i të rinjve nga fshati në qendrat urbane, madje edhe nga shteti është një problem serioz. Me anë të këtij projekti, do të adresohen nevojat e këtyre të rinjve në nivel më të lartë, dhe do të mbështeten për të afruar në burimet e ideve dhe iniciativave, si dhe në mjete financiare për të realizuar nevojat e tyre.

Projekti do të zgjat 18 muaj, gjegjësisht deri në qershor 2019.

Mapimi i të rinjve aktiv rural dhe OJQ në Rajonin Lindor dhe Juglindor

Anketa me pyetësor ishte zbatuar nga hulumtuesi në teren i angazhuar nga projekti, në shkolla të mesme paraprakisht të zgjedhura dhe me nxënësit e vitit të tretë dhe të katër të arsimit të mesëm. Zgjedhja e shkollave ishte bërë duke marrë parasysh numrin e nxënësve të regjistruar nga komunat e vogla rurale. Komunat e zgjedhura ishin: Shtip, Koçanë Vinicë, Dellçevë, Strumicë, Gjevgjeli, Radovish (si një prej komunave më të mëdha me shkolla të mesme). Numri i pjesëmarrësve në hulumtim në shkollat e ndryshme të mesme ishte përcaktuar në mënyrë proporcionale me numrin e nxënësve të regjistruar në shkollat.



Si konkluzion, në lidhje me mendimin e të anketuarve nga hulumtimi, vështirësitë kryesore të rajonit, përveç zhvillimit të infrastrukturës, janë, pjesëmarrja e të rinjve në proceset e krijimit të politikave dhe vendimeve, informacione më të mira për proceset e integritit në BE dhe mbi BE-në në përgjithësi, si dhe punësimi i të rinjve nga rajoni që shkakton një nivel të lartë të ikjes së personave (brain drain).

Në bazë të rezultateve, ekipi i hulumtimit propozon zhvillim dhe zbatim të punëtorive vijuese për të rinjtë nga rajoni:

- Aktivizëm rinor
- Metoda për pjesëmarrje në procese të politikave dhe marrje të vendimeve
- Udhëheqësi dhe shkathtësi tjera të buta dhe shkathtësi për punësim
- BE, institucionet e BE-së dhe integrimi i Maqedonisë në BE

